VENDIM
Nr. 931, datë 25.11.2020

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "SISTEMIMI I KRYQËZIMIT TË RRUGËS SË DURRËSIT ME UNAZËN", TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemimi i kryqëzimit të Rrugës së Durrësit me Unazën", Tiranë.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "tokë truall", me një vlerë të përgjithshme prej 35 035 735 (tridhjetë e pesë milionë e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 35 035 735 (tridhjetë e pesë milionë e tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë) lekësh, të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2020, i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë privatë, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.
8. Bashkia Tiranë të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësive në favor të shtetit, për pasuritë e shpronësuara.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela e pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që shpronësohen nga realizimi i projektit: "Sistemimi i kryqëzimit të Rrugës së Durrësit me Unazën", Tiranë

Nr.	*Emër Mbiemër*	*Zona kadastrale*	*Nr. pasurisë*	*Lloji i pasurisë*	*Sipërfaqja totale (m^2)*	*Sipërfaqe shpronësimi*	*Çmimi*	*Vlera totale lekë*	*Shënime*
						Tokë truall m^2	*Tokë truall /m^2*		
1	Bp. Metashi, Sulejmani, Mero, Bushkovi	8210	3/130	truall	107	107.0	38,164	4,083,548	
2	Bihane Ferzani	8210	3/124	truall	38	38.0	38,164	1,450,232	
3	Myrteza Myftari	8310	6/282	truall	805	805.0	31,219	25,131,295	Kufizohen veprimet. Dosja me reference 04057, sekuestruar nga Prokuroria.
4	Bp. Ylli, Gjinali, Myftiu dhe Llagami	8310	6/1304	truall	778.3	140.0	31,219	4,370,660	
Vlera totale e shpronësimit								**35,035,735**	

Shënime.
1. Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM-në nr.89, datë 3.2.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".